

1968-1969 - SHKRIRJA E AKUJVE NË BASHKËPUNIMIN KULTUROR SHQIPËRI-KOSOVË

Para disa muajsh, duke hulumtuar në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, rastësisht më ra në dorë një Raport i përgatitur nga një grup profesorësh të Universitetit Shtetëror të Tiranës, mbi vizitën e tyre në Prishtinë, në maj 1968. Duke lexuar dokumentin, e gjeta mjaft interesante përmbajtjen e tij, ku raportet Shqipëri-Kosovë trajtohen në disa plane: shkencor, arsimor, kulturor, ekonomik, kombëtar dhe politik. I parë nga një largësi kohore prej 48 vitesh, kur Kosova është shpallur republikë dhe Shqipëria është bërë një vend demokratik, e vlerësova si punë të lavdërueshme deklasifikimin e këtij dokumenti, dhe mendova se do të ishte e dobishme ta bëj atë të njohur për publikun shkencor dhe më gjerë.

Më 8 dhjetor 1967, Komiteti për Marrëdhënie Kulturore me Botën e Jashtme i RPSH, në një telegram dërguar Kuvendit të Kosovës, ftonte një delegacion të shqiptarëve të Jugosllavisë për të marrë pjesë në kremtimin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit –Skënderbeut, në Shqipëri. Më 2 janar 1968, këtij telegrami iu përgjigj Fadil Hoxha, kryetar i Kuvendit të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë. Fadil Hoxha vlerësonte në telegram rolin e Skënderbeut si një personalitet historik, rëndësia e të cilit i kalonte kufijtë kombëtarë të shqiptarëve, pasi ai luftoi kundër pushtuesve otomanë për mbrojtjen e lirisë të popullit shqiptar dhe popujve të tjerë të Ballkanit. Për këtë arsye, shprehej ai, 500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut do të kremtohej “bashkërisht në krahinën tonë nga shqiptarët, serbët, malazezët, turqit edhe të tjerët, të cilët e përbëjnë bashkësinë e popujve të Kosovë-Metohisë në kuadrin e RS të Serbisë, gjegjësisht RSF të Jugosllavisë”. Më tej, zoti Hoxha informonte se ky jubile përveçse në Kosovë do të kremtohej gjithashtu në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Malit të Zi, ku jetonte pjesa më e madhe e shqiptarëve në Jugosllavi. Përsa i përkiste ftesës së RPSH për një delegacion “të përbërë vetëm nga shqiptarë”, Fadil Hoxha bënte me dije se Kuvendi i Krahinës Autonome të Kosovës “nuk është kompetent me caktue delegacionin të përbamë prej shqiptarësh të kombësisë shqiptare që jetojnë në republikat e tjera të RSF të Jugosllavisë”¹.

¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), Viti 1968, Dosja 17/1, fl. 18.

Fadil Hoxha shprehte në telegram gatishmërinë e Kuvendit Krahinor që të dërgonte në Tiranë një delegacion që do të ishte “shprehje e përbërjes së popullsisë së krahinës autonome të Kosovës e Metohisë”, pra jo vetëm me studiues shqiptarë por edhe me studiues serbë e malazezë, që jetonin në Kosovë. Njëkohësisht ai ftoi një delegacion nga Shqipëria për të marrë pjesë në kremtimin e përvjetorit historik të Skënderbeut në Prishtinë, në maj 1968. Vizita e një delegacioni shqiptar në Kosovë, pas dy dekadash marrëdhënie të ngrira midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, sigurisht kishte një rëndësi të veçantë dhe zoti Hoxha jepte në telegram të gjitha garancitë se “delegacioni juaj do të gëzojë mikpritjen tonë të plotë dhe se do të respektohet plotësisht dinjiteti i RP të Shqipërisë”.²

Pas një letërkëmbimi disamujor ndërmjet strukturave përkatëse të RPSH dhe të KAKM, një delegacion i profesorëve të mirënjohur të Universitetit Shtetëror të Tiranës, i përbërë nga prof. Aleks Buda, prof. Ndreçi Plasari, prof. Bujar Hoxha, prof. Dhorka Dhamo, prof. Thoma Murzaku, dr. Mediha Shuteriqi arriti në Kosovë më 8 maj 1968. Për dhjetë ditë me radhë [gjashtë ditë delegacioni qëndroi në Kosovë], delegacioni u prit dhe u trajtua në mënyrë korrekte nga drejtuesit e Institutit Albanologjik dhe nga Bashkësia e shkollave të larta në Prishtinë, e më pas në Shkup. Delegacioni mori pjesë në simpoziumin e organizuar me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut në Prishtinë dhe vizitoi disa qytete të Kosovës, si Prizrenin, Pejën, Gjakovën dhe Mitrovicën. Anëtarët e delegacionit patën takime të organizuara dhe spontane me kolegët e tyre kosovarë: studiues dhe pedagogë, me studentë, fshatarë dhe politikanë.

Organizatorët e simpoziumit u propozuan profesorëve nga Tirana dhe një takim të veçantë [pa pjesëmarrjen e delegacioneve të huaj të ftuar në simpozium] me drejtuesit politikë të Kosovës, por anëtarët e delegacionit shqiptar nuk pranuan.

Gjithashtu profesorëve nga Shqipëria iu propozua të vizitonin edhe Beogradin, por edhe propozimi i dytë u refuzua. Ky qëndrim mbahej për shkak të dallimeve ideologjike e politike që ekzistonin midis RPSH dhe RFPJ. Pas vitit 1948, kur PKJ u përjashtua nga Informbyroja, udhëheqja politike shqiptare dhe ajo jugosllave kishin ndjekur rrugë të ndryshme në organizimin politik, ekonomik e shoqëror në vendet e tyre. Për më shumë, ato ishin në kundërshti dhe armiqësi me njëra tjetrën. PKJ eci në rrugën e revizionimit të teorisë marksiste-leniniste dhe ndoqi një rrugë të veçantë në ndërtimin e socializmit brenda vendit, ndërsa në politikën e jashtme qëndroi jashtë blloqeve kryesore të Luftës së Ftohtë. Ndërkaq PPSH i qëndroi besnike teorisë tradicionale marksiste-leniniste deri dhe stalinizmit, dhe, u rreshtua në Bllokun Komunist të Lindjes me në krye Bashkimin Sovjetik. Të dy qeveritë kishin tërhequr

² *Po aty*, fl. 18-19.

legatat e veta dhe në ndonjë rast të veçantë merreshin vesh nëpërmjet ambasadave përkatëse në Hungari e më vonë në Rumani.

Marrëdhëniet e ngrira diplomatike midis dy vendeve në vitet 1950-1953 u normalizuan vetëm pas vdekjes së Stalinit. Pas marsit të vitit 1953, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik u afrua me Lidhjen Komuniste Jugosllave dhe në të gjithë Bllokun e Lindjes u zhvillua intensivisht kursi i destalinizimit. Ndërsa PPSH nuk e pranoi atë kurs. Midis Jugosllavisë nga një anë dhe BS e vendeve të tjera komuniste të Evropës Lindore nga ana tjetër, u normalizuan jo vetëm marrëdhëniet shtetërore por edhe marrëdhëniet partiake, ndërsa me Shqipërinë kjo nuk ndodhi. Josip Broz Tito nuk e fshihte qëllimin e tij për të pasur një udhëheqje jostaliniste e miqësore në Shqipëri. Ndërsa Enver Hoxha bllokoi çdo ndikim e ndërhyrje jugosllave në vend. Madje për çdo mosarritje dhe dështim në politikën shqiptare, Jugosllavia do të ishte referenca kryesore.

Vetëm pas ndarjes së udhëheqjes shqiptare me atë sovjetike, në vitin 1961, marrëdhëniet shqiptare-jugosllave patën një lloj përmirësimi. Kjo se BS shihej si kundërshtar i përbashkët potencial i Shqipërisë dhe i Jugosllavisë. Gjithashtu në plan ndërkombëtar tensionet e Luftës së Ftohtë kishin rënë, erërat e Detantës përfshinë dhe Ballkanin, ku marrëdhëniet e vendeve ballkanike përjetuan një lloj shtendosjeje. Edhe situata politike në Jugosllavi, ku ndryshimet kushtetuese sollën me vete kalimin e një varg kompetencash të Federatës në republikat dhe në krahinat autonome, i lejuan kosovarëve dhe klasës politike të Kosovës të shtrojnë një varg kërkesash për përmirësimin e statusit të krahinës së tyre. Ata arritën që në vitin 1969 të kenë Ligjin e tyre kushtetues dhe në vitin 1974, Kushtetutën e Kosovës. Në këto koniunktura u bë i mundshëm jo vetëm afrimi midis RPSH dhe RSFJ, por edhe ndërmjet RPSH dhe KAKM.

Delegacioni i profesorëve të Universitetit Shtetëror të Tiranës u prit në Prishtinë me dashuri dhe ngrohtësi të jashtëzakonshme. Ishin ndjenjat e fuqishme patriotike që identifikoheshin me shtetin shqiptar amë, Shqipërinë. Këtë e dëshmonte qartë numri i madh i studentëve kosovarë, nxënësve, mësuesve, intelektualëve, dhe qytetarëve të Kosovës që donin të takoheshin me anëtarët e delegacionit, që i ndiqnin ata në hotele, në ndërtesën e simpoziumit, në çdo ambient tjetër ku vendoseshin; sytë e përlotur të pleqve dhe të të rinjve; buqetat e shumta me lule të lidhura me fjongo kuq e zi - simbol i flamurit kombëtar, që kosovarët mbanin në duar për t'ua dhuruar profesorëve nga Tirana; duartrokitjet e zgjatura për kumtesat e tyre; këngët patriotike që këndoheshin në ambientet jashtë sallës së simpoziumit e të tjera e të tjera. Gjithçka ishte një shpërthim i pakufishëm emocionesh që la pa gojë jo vetëm profesorët shqiptarë por edhe profesorët e huaj që merrnin pjesë në simpozium. "Këtu qenka një vullkan i pashuar", u shpreh një profesor nga Gjermania Perëndimore. Gjithçka ishte spontane, e paorganizuar. Ishte dashuria, dhimbja dhe krenaria e një populli të ndarë, që për dekada me radhë i ishte imponuar statusi i minoritetit dhe kishte përjetuar gjithë reperkusionet etnike dhe politike

që rridhnin prej tij. Në Prishtinë kishin ardhur profesorë nga Universiteti i Tiranës dhe për kosovarët, ky ishte një sinjal ogurmirë se Shqipëria po bëhej përsëri e afërt.

Sigurisht, për profesorët nga Tirana, entuziazmi i kosovarëve ishte i mirëpritur. Ndjenjat kombëtare ishin të përbashkëta, një popull, një gjuhë, një konstruksion shpirtëror. Por në shtetin shqiptar, ideologjia komuniste staliniste ishte sunduese dhe kjo do të thoshte se ndjenjat kombëtare duhej të kalonin në plan të dytë. Le të mos themi pastaj që Lidhja Komuniste e Jugosllavisë për udhëheqjen politike shqiptare mbetej bastioni i revizionizmit dhe tradhtisë komuniste. Është kjo arsyeja që delegacioni shqiptar krahas distinktivëve dhe kartolinave të Heroit Kombëtar, Skënderbeut, filloi t'u shpërndajë studentëve shqiptarë dhe kartolina të Enver Hoxhës. Në kushtet kur midis Beogradit dhe Tiranës raportet ideologjike ishin të paharmonizuara, madje kundërshtuese, kjo ishte një lojë e rrezikshme politike. Nëpërmjet një veprimtarie legale zhvillohej një veprimtari ilegale nxitëse. Spekulohej me ndjenjat e ndezura të rinisë studentore kosovare, kur një platformë e shtetit shqiptar për çështjen e Kosovës mungonte, kur Perëndimi dhe Lindja ishin të vendosur të ruanin Federatën Jugosllave dhe kur vetë Shqipëria ishte pa mbështetje ndërkombëtare. Prandaj e konsiderojmë të drejtë ndërhyrjen e prof. Fehmi Aganit, jo vetëm si ndjeshmëri dashamirëse e profesorit për studentët e tij, por edhe si një qëndrim zyrtar, që mund të sillte tronditje të paparashikuara. Organet e Sigurimit në Jugosllavi, ashtu si dhe në Shqipëri, ishin veshi dhe syri i pushtetit komunist, madje ishin organet më represive të sistemit dhe studentët duheshin mbajtur sa më larg tyre.

Një figurë tjetër që të tërheq vëmendjen në këtë dokument është edhe ajo e prof. Bujar Hoxhës, anëtar i delegacionit, kosovar nga origjina familjare, por që jetonte e punonte në Republikën Popullore të Shqipërisë. Grupi i delegacionit vendosi që Bujar Hoxha të mos e takonte Fadil Hoxhën, atëkohë kryetar i Kuvendit të Kosovës, dikur bashkënxënës dhe bashkëluftëtar kundër pushtuesve fashistë italianë dhe nazistëve gjermanë. Prof. Hoxha iu bind disiplinës së grupit. Ishte koha kur njeriu fliste dhe vepronte ndryshe nga ç'mendonte. Sigurisht dëshira e tij nuk ishte kjo, por politika ishte imponuese. Se çfarë mendonte prof. Hoxha për Fadil Hoxhën, e dëshmojnë këto radhë të shkruara prej tij në vitin 1991, kur demokracia sapo kishte trokitur në Shqipëri dhe njeriu ishte i lirë të shfaqte hapur ndjenjat dhe mendimet e tij: "E njoh Fadil Hoxhën si trim, të ndershëm dhe atdhetar"³, do të shkruante ai për mikun e dikurshëm. Megjithatë duhet thënë se edhe në vitin 1968, ndjenjat kombëtare mbijetonin nën lëvozhgën e politikës. Jo më kot Ilia Vakić, kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Krahinës iu drejtua prof. Bujar Hoxhës për të biseduar për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Kosovës dhe

³ Fadil Hoxha, *Një jetë në shërbim të atdheut*. "Fadil Hoxha personalitet i historisë sonë", Prishtinë: Shoqata e veteranëve të LANÇ të Kosovës – Prishtinë, 2007, f. 134.

Shqipërisë. Nga të gjithë anëtarët e delegacionit, Bujar Hoxha ishte ai që mund t'i kuptonte më mirë nevojat e bashkatdhetarëve të vet kosovarë dhe do t'ia çonte atje ku duhej fjalën e tij. Dhe me maturinë dhe guximin e tij ai bëri jo pak.

ANA LALAJ

RAPORT

mbi vizitën e grupit të punonjësve shkencorë të Universitetit Shtetëror të Tiranës në Kosovë me rastin e Simpoziumit kushtuar Skënderbeut

Pritja zyrtare e grupit

Vizita në Kosovë e punonjësve shkencorë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, e përbërë nga shokët Aleks Buda, Ndreçi Plasari, Bujar Hoxha, Dhorka Dharmo, Mediha Shuteriqi dhe Thoma Murzaku, zgjati prej 8 deri 18 maj 1968. Grupi mori pjesë në simpoziumin kushtuar Skënderbeut në Prishtinë, i cili zgjati tre ditë e vizitoi përveç Prishtinës dhe qytetet Prizren, Pejë, Gjakovë e Mitrovicë. U bënë vizita në dy fabrika [tekstileshe dhe konfeksionesh], në Institutin e Albanologjisë, në fakultetet juridik-ekonomik e të filozofisë, në entin e botimeve dhe të teksteve shkollore, në një numur shkollash normale dhe Institutesh dyvjeçare pedagogjike dhe teknike e në një shkollë bujqësore. U bë takim me njerëzit e letërsisë dhe artit [shqiptar]. Në të kthyer në atdhe patëm një takim në Shkup me historianë e të tjerë nga Maqedonia që morën pjesë në simpoziumin e Prishtinës.

Ne ishim të ftuar nga Instituti i Albanologjisë dhe nga bashkësia e shkollave të larta.

Grupit i është bërë në përgjithësi një pritje zyrtare korrekte. Përgjegjësit e ngarkuar për të na pritur dhe përcjellë janë munduar që të mbeteshim të kënaqur nga vizita. Por në të njëjtën kohë janë përpjekur në çdo mënyrë që të na mbanin të veçuar nga masat e rinisë e të popullit në përgjithësi, duke mos na dhënë mundësi për takime të lira me të rinjtë, me punëtorë, me fshatarë dhe të tjerë.

Gjatë vizitës nuk pati ndonjë incident të rëndë.

Si sjellje jo korrekte nga ana e vendasve mund të përmendet ndryshimi që i kishin bërë, pa na pyetur fare, një fjale të tekstit të dedikimit në kurorën që

vumë në vendin ku ishte kampi nazist i Prishtinës. Ne e vendosëm kurorën vetëm pasi u bë ndryshimi i nevojshëm.

Pati edhe një orvatje provokimi në darkën zyrtare të lamtumirës që u dha për grupin tonë. Dekani i fakultetit teknik [serb], i pranishëm në darkë, filloi të këndonte këngën e Titos me qëllim të hapur që të prishte pritjen e të krijohej incident. Po t'i kishin bërë jehonë të tjerët ne do të largoheshim në mënyrë demonstrative. Por menjëherë dy nga të pranishmit [shqiptarë kosovarë] filluan një këngë popullore serbe dhe e lanë vetëm dekanin që e mbylli gojën. Kështu provokimi dështoi.

Një ndodhi tjetër që mund të krijonte incident ishte shpërndarja e disa fotografive [kartolina] të shokut Enver. Ne kishim marrë me vete nja 300 copë kartolina me panorama nga Shqipëria, në mes tyre dhe 30 copë fotografi të shokut Enver. Kur e morëm nga makina jonë pakon me kartolina, një grumbull të rinjsh që ndodheshin rrotull, me të marrë vesh, filluan të kërkonin me këmbëngulje kartolina. Deri në një farë vendi ne ua lëshuam në duar gjithë kartolinat. Nxënësit dhe studentët i thëthinë përnjëherësh. Brenda atyre ditëve me qindra fotografi të shokut Enver u riprodhuan nëpër laboratorët personalë.

Pas nja dy orësh kur ndodheshim në simpozium, një nga bashkëpunëtorët e Institutit të Albanologjisë na njofton se “UDB kërkon të dëbojë jashtë Jugosllavisë shoferin Teki Malaj sepse e akuzon që ka shpërndarë fotografi të Enver Hoxhës”. E vumë në dijeni menjëherë për këtë, drejtorin e Institutit, Fehmi Agani. I shpjeguam se disa fotografi të Enver Hoxhës bashkë me kartolinat e tjera që donim t’ua jepnim të huajve na i rrëmbyen me zor nga duart të rinjtë dhe e paralajmëruam se po të dëbonin shoferin do të detyroheshim të largoheshim të gjithë nga Jugosllavia. Pas një ore, drejtori i Institutit na jep përgjigje se çdo gjë u rregullua, shoferi nuk do të dëbohej por vetëm të porositej që të mos shpërndante distinktivë të Skënderbeut dhe materiale të tjera.

Shpërndarja e distinktivëve [me portretin e Skënderbeut dhe me flamurin e kuq me shkabë të zezë] që kishim marrë me vete [rreth 3000 copë] u shndërrua në një aksion politik. Përpara se të fillonim ndarjen në masë të tyre, ne u dorëzuam 300 copë organizatorëve të simpoziumit për t’ua dhënë pjesëmarrësve. Mirëpo ata ndanë një numër fare të vogël dhe pjesën tjetër e mbajtën. Kërkesa për të tilla distinktivë si brenda ashtu dhe jashtë simpoziumit ishte kaq e madhe sa s’bëhet. Njerëzve u dukej distinktivi si gjëja më e vyer, kur e merrnin e puthnin. Ne filluam t’i shpërndanim në masë, si brenda dhe jashtë ndërtesës së simpoziumit. Krijohej një rrëmujë e madhe. Njerëzit shtyheshin se kishin frikë se mos mbeteshin pa marrë shenjëza. Edhe në mes të natës vinin në hotel për të kërkuar shenjëza. Kjo gjë i alarmoi organizatorët e simpoziumit dhe autoritetet e vendit. Na u kërkua kategorikisht që të ndërprisnim shpërndarjen e distinktivëve si në Prishtinë, ashtu edhe në qytetet e tjera ku do të shkonim. “Shpërndarja e distinktivëve mori një karakter politik,

thoshin. Ju lutemi ndaloni shpërndarjen. UDB po fotografon njerëzit që marrin distinktivë. Na i jepni ne se i ndajmë vetë”. Ne u përgjigjeshim se nuk kishte asnjë arsye të ndalohej shpërndarja, as përse të shqetësoheshin. Ato ishin emblema të Skënderbeut dhe jo të RPSH. E shfrytëzuam këtë rast për biseda me të rinjtë, duke u thënë hapur atyre se na e kishin ndaluar shpërndarjen dhe e lidhnim me demagogjinë që përdorin autoritetet jugosllave për t’u dhënë gjoja shqiptarëve liritë dhe të drejtat demokratike kombëtare. Ne e vazhduam deri në fund shpërndarjen e distinktivëve, vetëm evituam rrëmujën, duke mos i dhënë në grupe të mëdha, por njerëzve të veçuar nën dorë.

Duhet thënë se pati edhe njerëz të liq që distinktivët i shisnin. Çmimi i një shenjëze vajti 5000 dinarë të vjetër.

Nga vendasit na u propozua që pas simpoziumit të shkonim në Beograd për të vizituar universitetin dhe institucione të tjera shkencore. Ne nuk pranuan. Nuk pranuan gjithashtu propozimin për një takim zyrtar me autoritetet e larta të Kosovës, Fadil Hoxhën, Ilia Vakić-in etj. Pas këtij kundërshtimi Fadil Hoxha kërkoi një takim me Bujar Hoxhën. As kjo nuk u pranua. Ilia Vakić pati një bisedë me Bujarin në pritjen zyrtare që u dha nga Sali Nushi [kryetar i Dhomës për Arsimin dhe Kulturën].

Ne nuk pranuan edhe një propozim tjetër që na u bë për t’i dhënë një karakter zyrtar qëndrimit tonë një natë në Shkup, ku na u kërkua të ishim mysafirë të Institutit të Historisë Kombëtare të Maqedonisë dhe të bënim një vizitë në këtë institut.

Të gjithë këto propozime bënin pjesë në orvatjet për ta futur vizitën tonë në Kosovë në kuadrin e “përmirësimit e të zgjerimit të marrëdhënieve ndërshtetërore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë”.

Veç kësaj, propozimi për të na dërguar në Beograd kishte qëllim që të na largonin nga Kosova. Kjo u duk edhe në shkurtimin e vizitës nëpër Kosovë nga 10 ditë [që ishte paraparë] në 6 ditë.

Zhvillimi i simpoziumit dhe takimet shkencore

Simpoziumi kushtuar 500 vjetorit të Skënderbeut pati një karakter të dyfishtë: ai nuk kishte vetëm një anë shkencore, por njëkohësisht dhe më tepër, karakterin e një manifestimi të fuqishëm patriotik të shqiptarëve të Kosovës. Komisioni iniciator padyshim synonte ta vinte në dukje këtë funksion patriotik, por trembej nga ana tjetër se mos merrte karakter tepër masiv. Për këtë arsye salla në të cilën u zhvillua simpoziumi ishte zgjedhur tepër e vogël në krahasim me kërkesat e mundësitë. Kështu mbetën jashtë shumica më e madhe e arsimtarëve dhe e studentëve të shkollave të larta; nuk morën pjesë veçse në shkallë shumë të kufizuar edhe përfaqësues të shtresave të gjera patriotike. Kështu pjesëmarrja që e kufizuar rreth 300 vetëve në fillim. Por me insistimin e arsimtarëve dhe studentëve u lejua që këta të mbushnin galerinë, kështu që

numri i pjesëmarrësve arriti deri në 500. Siç tha vetë kryetari i Komisionit iniciator, prof. Idriz Ajeti, komisioni kishte frikë se mos “ndonjë provokator mund të nxiste studentët që prej natyre janë të zjarrtë, të bënë ndonjë hap të pamatur, që do të bënte të pamundur mbajtjen e të tilla mbledhjeve në të ardhmen”.

Simpoziumin e përshëndetën me telegrame një varg shkollash, institucionesh, grupe qytetarësh, punëtorë, studentë e fshatarë shqiptarë nga vise të ndryshme, edhe jashtë Kosovës. Dhënia njoftim për arritjen e këtyre telegrameve dha shkas për shpërthimin e duartrokitjeve të stuhishme në sallë.

Mund të thuhet se simpoziumi pati sukses sidomos në drejtimin e dytë. Nëse ai u bë një manifestim i fuqishëm i patriotizmit popullor të shqiptarëve të Jugosllavisë përtej caqeve, ku donin ta mbanin qarqe të interesuara, kjo qe meritë në radhë të parë e patriotizmit të masave popullore kosovare, po edhe e delegacionit të ardhur nga RP të Shqipërisë. Kumtesat e delegacionit kontribuuan gjithashtu për të ngritur nivelin shkencor të simpoziumit.

Në simpozium u mbajtën rreth 40 kumtesa. 6 nga këto prej delegacionit tonë, 19 prej shkencëtarësh shqiptarë nga Jugosllavia [Kosovë, Maqedoni etj.], 12 nga shkencëtarë jugosllavë dhe 4 nga përfaqësues shtetesh të huaj [Bashkimi Sovjetik, Austri dhe Gjermania Perëndimore].

Referatin kryesor e mbajti Ali Hadri, që konsiderohet si historian kryesor dhe dihet se është njeriu i mbështetur nga regjimi titist. Referati qe në një nivel shkencor të ulët, ishte më tepër një ritregim faktesh, pa ndonjë material dhe koncept të ri të vetin. Në fund ishin shtuar disa konkluzione përgjithësuese që ishin marrë hua nga punimet e bëra në vendin tonë. Përgjithësisht mund të thuhet se kumtesat e mbajtura nga shqiptarët vendas ishin në një nivel shkencor mjaft të ulët; ato i përshkonte përgjithësisht fryma patriotike por metodologjikisht ishin të dobëta dhe nuk sillnin ndonjë rezultat shkencor për t'u shënuar. Nga kumtesat më të mira mund të konsiderohet ajo e Rexhep Qoses me titull “Skënderbeu në vizionin poetik të Naim Frashërit” që binte në sy për trajtimin e thellë e të drejtë të temës, për kulturën e gjerë të autorit etj. Për ndonjë material të ri nga arkivat turke kishin interes kumtesat e Skënder Rizajt dhe Hasan Kaleshit, ndonëse nuk u mungonin nga ana tjetër, edhe pikëpamje të shtrembra në lidhje me vlerësimin e pushtimit osman [në këtë çështje ata janë viktima të mënyrës shtrempëruese të të parit të këtij problemi që gjendet te një varg historianësh turq, gjermano-perëndimorë etj.]. Punimet e tjera të autorëve kosovarë përpiqeshin të ilustronin figurën e Skënderbeut në pasqyrimin e tij të shumanshëm në letërsi dhe folklor. Mund të thuhet se siç e thoshin vetë edhe autorët e tyre, këto kumtesa për një pjesë të mirë mbështeteshin mbi materialet e studimet e autorëve të RP të Shqipërisë.

Edhe një varg autorësh jugosllavë kontribuuan për ta vënë në dukje pasqyrimin e fuqisë së Skënderbeut në letërsinë e folklorin e popujve të ndryshëm [të maqedonasve, serbo-kroatëve, sllovenëve, hungarezëve etj.].

Rëndësinë më të madhe ndër kumtesat e shkencëtarëve jugosllavë e patën kumtesat e një profesori të Sarajevës, Adem Hanxhić dhe të një historianeje të Shkupit, G. Palikrusheva. Ndonëse nuk kishin të bënin drejtpërdrejt me Skënderbeun, këto dy kumtesa kishin një rëndësi sepse vërtetohet - në bazë të dokumenteve turke të viteve 1455-1467 - se turqit gjetën në viset e brendshme ballkanike një popullsi të gjerë shqiptare. Me këtë bie poshtë plotësisht teza e shovinistëve serbë që vazhdon të mbahet edhe sot nga historiografia titiste, se shqiptarët kanë ardhur në Kosovë e Maqedoni vetëm në shekullin XVII-XVIII.

Autorët [nënkupto: studiuesit] e huaj [dy austriakë, një gjerman përëndimor e një sovjetike] nuk sollën ndonjë gjë të re për njohjen e epokës së Skënderbeut. Kumtesat e tyre, ndonëse nuk patën ndonjë rëndësi shkencore, përshkoheshin nga fryma e simpatisë për heroin shqiptar dhe luftën e udhëhequr prej tij. Nga austriaku R. Schwanke u shpreh mendimi se figura dhe epoka e Skënderbeut do të ilustronin në mënyrë të kënaqshme shkencore vetëm atëherë kur “të pajtohen tezat e Aleks Budës me pikëpamjet e historianit turk H. Inalxhik [Halil Inalcik] dhe të jezuitit Zef Valentini në frymën e UNESCO-s”.

Në diskutimin e vet Aleks Buda vuri në dukje arsyet shkencore përse nuk qëndrojnë në këmbë shkencërisht pikëpamjet e H. Inalxhikut mbi karakterin gjoja progresiv të pushtimit osman në Shqipëri dhe të Zef Valentinit mbi karakterin e luftës së shqiptarëve si një luftë gjoja për mbrojtjen e krishterimit. Gjithashtu ai plotësoi disa kumtesa nga ana materiale ose në lidhje me vlerësimin e tyre [si p.sh. në lidhje me marrëdhëniet e Skënderbeut me Mbretërinë e Napolit që kanë lënë shteg për interpretime të gabuara]; më në fund ai vuri në dukje rëndësinë e madhe të konkluzioneve që mund të nxirren nga kumtesat e Hanxhić-it dhe Palikrushevës në lidhje me praninë e shqiptarëve në viset e brendshme ballkanike; prej këndeje duhet nxjerrë konkluzioni që përmbys një literaturë të tërë të shkruar me prapamendime e në mënyrë jo objektive jo vetëm në kohën e kaluar, por edhe sot; një rast i tillë shtrembërues është studimi gjoja shkencor i botuar nga Akademia e Shkencave të Serbisë, me autor A[tanasije] Uroshević, ku janë shtrembëruar plotësisht të dhënat rreth historisë së popullsisë shqiptare në Kosovë.

Më në fund u vu në dukje se ç’punë e madhe shkencore është bërë ose është duke u bërë në RP të Shqipërisë në lidhje me studimin e epokës së Skënderbeut dhe u dha njoftim mbi gjithë botimet e bëra me këtë rast ose që janë duke u shtypur.

Kumtesat dhe diskutimet tona u pritën kurdoherë me duartrokitje të gjata e të stuhishme; po ashtu binte në sy mënyra e zjarrtë me të cilën përshëndeteshin kumtesat që kishin për autorë shqiptarë nga Jugosllavia. Po edhe këtu bëhej diferencimi. Kur u mbajt p.sh. kumtesa e Shefqet Pllanës, që njihet si agjent i bindur titist, më se gjysma e të pranishmëve e braktisi sallën në shenjë proteste.

* *

*

Institucionet shkencore në Kosovë janë duke bërë hapat e para në punën kërkimore. Kjo vlen edhe për Institutin Albanologjik, të vetmen qendër shkencore që i kushtohet studimeve albanologjike në Jugosllavi

Veprimtaria e Institutit Albanologjik pengohet ndër të tjera edhe nga fakti që nuk ka forca të mjaftueshme, sepse këto forca janë shpërndarë në mënyrë jo racionale. Kështu p.sh. përveç këtij instituti të kryesuar nga Fehmi Agani, ekziston edhe një institut tjetër nën kryesinë e Ali Hadrit me emër “Enti Historik” që në dukje ka po ato qëllime, të studiojë historinë e kësaj zone. Por “Enti Historik” ka një funksion të caktuar, ai synon të studiojë historinë e Kosovës jo nën prizmin shqiptar, por edhe të sllavëve, pra synon një farë diversioni e përçarjeje në konceptin e studimeve albanologjike. Me sa na u tha, “Enti Historik” do t’u shkrija me Institutin Albanologjik, porsa të mbaroka një detyrë të posaçme që paska, të hartojë një histori të Kosovës e Metohisë në shekujt XIX-XX.

Tani për tani, Instituti Albanologjik ka vetëm 7-8 bashkëpunëtorë e do të merret me studimin në fushën e historisë, gjuhës e letërsisë shqipe dhe folklorit.

Në planin e 1968 bëjnë pjesë këto çështje:

- Përgatitja e sesioneve shkencore kushtuar 90 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit dhe 60 vjetorit të Kongresit të Manastirit.

Për këtë qëllim Instituti po vazhdon të mbledhë dokumente arkivore nga Cetina, Beogradi, Vjena dhe Stambolli dhe ka mbledhur një sasi të konsiderueshme që do të fillojë të botojë.

- Do të ribotojë një fjalor serbisht –shqip të ripunuar të Sokol Dobroshit.

- Do të vazhdojë mbledhjen e folklorit të shqiptarëve të Jugosllavisë, për ta botuar në seri.

- Do të studiojë dialektet shqiptare në Jugosllavi dhe pasqyrimin e ndikimit të shqipes në gjuhët fqinje sllave.

- Do të botojë dy numra vjetore të organit të tij “Gjurmime Albanologjike”.

Është e qartë se ky plan kërkon një punë shumëvjeçare dhe angazhimin e një ekipi shumë më të madh bashkëpunëtorësh. Për këto arsye nga Instituti Albanologjik i Prishtinës u ngrit kërkesa për të intensifikuar bashkëpunimin me Institutin e Historisë e Gjuhësisë në Tiranë duke arritur një farë ndarje pune dhe duke marrë pjesë bashkërisht në disa punime, siç është p.sh. botimi i dokumentacionit etj. Nga ana tjetër këtu, si dhe në një varg institucioneve të larta arsimore u ngrit kërkesa që Universiteti ynë të ndihmojë në kualifikimin e kuadrit shkencor albanologjik, duke lejuar në institutet tona të punojnë për specializim punonjës shkencorë kosovarë.

Nga ana jonë u mbajt një qëndrim i rezervuar kundrejt këtyre kërkesave.

Në shkollat e larta dhe të mesme që vizituam binte në sy që elementi shqiptar, ndonëse në krahina përbën shumicën absolute, në këto shkolla nuk

arrin po këtë përpjesëtim porsa i përket numrit të nxënësve. Gjithashtu bie në sy se kudo mbizotëronte ndër nxënësit elementi qytetar ndaj atij fshatar, elementi mashkullor ndaj atij femëror.

Puna e arsimtarëve pengohet nga fakti se ata në një varg rastesh nuk kanë tekste shqip për lëndët që zhvillohen, se nuk janë në gjendje t'i përkthejnë vetë këto tekste për mosnjohje të terminologjisë përkatëse shqipe etj. Kjo i jep mundësi elementit serb të uzurpojë një varg lëndësh që mbahen në gjuhën serbisht gjoja se shqipja nuk qenka e përshtatshme dhe e aftë për të dhënë mësim, veçanërisht në lëndët e shkencave natyrore.

Për këtë arsye u ngrit në çdo shkollë kërkesa që këto shkolla pedagogjike të furnizohen rregullisht me botimet, programet e tekstet përkatëse të Institutit Pedagogjik 2-vjeçar të Shkodrës si dhe me çdo botim gjuhësor-letrar-historik që mund t'i vlejë shkollës. Deri tani kanë pasur rrallë ndonjë botim shqiptar që u ka rënë rastësisht në dorë. Edhe këtu u shpreh nevoja që arsimtarët e këtyre instituteve të mund të kualifikohen pranë shkollave të larta të RP të Shqipërisë dhe që studentët të mund të njohin drejtpërdrejt në Shqipëri një varg punimesh që i përkasin historisë ose gjuhësisë.

Në Shkup delegacioni ynë pati rast të takohej me disa historianë maqedonas, midis tyre drejtori i Institutit të Historisë në Shkup, Apostolski. Ata shprehën në mënyrë të theksuar nevojën e dobënë për të dy palët që të shkëmbejnë literaturë, informata mbi rezultatet e kërkimeve të tyre etj. Në mënyrë të veçantë vunë në dukje se ata kanë shtënë material shumë me vlerë për historinë e Shqipërisë nga arkivat turke, që duan, por nuk mund t'i botojnë në Jugosllavi, se nuk i përkasin profilit të organeve të tyre. Prandaj ata kanë kërkuar mundësinë që t'i botonim në organet shqiptare. Nga ana e tyre u tërhoq gjithashtu vëmendja se në arkivat e Manastirit ka një pasuri të madhe dokumentesh për historinë e Rilindjes shqiptare që ka mbetur e pashfrytëzuar e do të mbesë e tillë, po nuk erdhën vetë shqiptarët për t'i mbledhur.

Nga ana e historianëve shqiptarë të Shkupit [tre vetë që punojnë në Institutin e Historisë] u shpreh më në fund nevoja që atyre t'u jepet mundësia të konsultojnë materialet shqiptare [dokumente e studime] përpara se të dalin këto nga shtypi, kështu që të jenë në gjendje ta presin deri diku denjësisht përvjetorin e Kongresit të Manastirit. Kjo ka rëndësi të veçantë për Maqedoninë, ku shqiptarët rrojnë e veprojnë në kushte akoma më të vështira se në Kosovë.

Takim me masat

Pritja që iu bë grupit tonë nga masat ndryshonte krejt nga pritja zyrtare. Opinioni i gjerë i shqiptarëve e quajti vajtjen tonë një ngjarje historike. Ditëve që zhvillohej simpoziumi masat u dhanë një ngjyrë feste. 5-6 ditë rresht nxënësit dhe studentët i braktisën shkollat. Turma të rinjsh grumbulloheshin

përpara hotelit ku ishim vendosur ne, në hyrjen e godinës ku zhvillohej simpoziumi, nëpër rrugët dhe qëndronin deri pas mezit të natës. Këndonin këngë popullore. Dëshira e tyre e zjarrtë ishte të na takonin, të bisedonin me ne, të na shprehnin ndjenjat e tyre të flakta patriotike. Për t'u takuar me shokët e grupit, kishin ardhur në Prishtinë të rinj e një numër fshatarësh jo vetëm nga viset e Kosovës por edhe nga Dibra, Gostivari, Tetova, Kërçova, nga Presheva etj.

Autoritetet e vendit, organet e Ministrisë së Brendshme kishin marrë masa të shumta për të mos lejuar takimin e masave me ne. Policët i shpërndanin grumbujt e njerëzve me forcë. Kur vizitonim fakultetet dhe shkollat gjenin kohën dhe merrnin masa që nxënësit e studentët të mos ndodheshin të pranishëm, ose të ishin në mësim, për t'i dhënë vizitës vetëm karakterin e takimit me drejtuesit e pedagogët. Mirëpo nuk kishte forcë që t'i përmbante nxënësit e studentët. Mblidheshin turma të tëra, në kundërshtim me urdhrat, dhe i bënin kudo grupit tonë pritje të zjarra. Agjentë të posaçëm i largonin dhe mundoheshin t'i shpërndanin nxënësit e studentët që afroheshin. Njerëzit e UDB ishin në aktivitet të madh. Gjurmonin pa pushim kush tregohej më i ekzaltuar, kush puthej e përqafohej me ne, kush qante nga mallëngjimi, kush thoshte fjalë kundër regjimit e politikës shoviniste titiste. Kishte edhe studentë e nxënës që ruheshin e tregoheshin më të përmbajtur, por shumica nuk donin t'ia dinin fare se ç'bënte UDB, policia ose autoritetet shkollore.

Nxënësit e studentët shprehnin dashurinë për RPSH, për Partinë e Punës të Shqipërisë, për shokun Enver që e quanin zakonisht "Skënderbeu i gjallë". Afroheshin e na pëshpëritnin në vesh: "Si është shoku Enver? Jepini të fala shokut Enver! Putheni për ne shokun Enver!" Të rinjtë e thoshin hapur se në Jugosllavi nuk kishte asgjë socialiste, se ajo është një vend kapitalist, si çdo vend tjetër kapitalist. Edhe me anë të letrave që na futeshin nëpër xhepa edhe me fjalë, ata tregonin se qëllimi i tyre më i lartë ishte "bashkimi i Kosovës me RPSH".

Në Pejë nxënësit e shkollës normale kishin dalë në ballkon, kishin varur një portret të Skënderbeut të vizituar nga një student, pa dijeninë e drejtorisë, e kishin rrethuar me flamurin kuq e zi dhe këndonin këngën "Kushtrimi" të shkruar dhe kompozuar nga diletanti Zekiria Çarkaxhiu, këngë, këngë që ishte kthyer në një hymn. Këtë këngë e këndonin edhe fëmijët nëpër rrugë.

Kënga tingëllonte:

"Si rrufe u përhap kushtrimi,
Kudo ndër shqiptarë
S'durojmë prangat e robnimit,
Për pa vdes ma parë

Refren:

Hej trim o Skënderbe!
 O krenari shqiptari
 Për të çlirue atdheun
 N'luftë hidhesh i pari!

Recital:

Po ku jeni nis kështu o burra?
 Vendin ta çlirojmë!
 Po qe besa edhe mua do merrni
 Se kështu s'mund durojmë!

T'japim besën t'gjithë sa jemi
 Trim o Skënderbe!
 Për atdhe jetën shqiptari
 E jep si me le
 Hej trim o Skënderbe etj...

Pastaj kur zbritëm poshtë, më tepër se 200 nxënës, duke kënduar këngën e mësipërme me portretin e Skënderbeut në ballë drejtohen nga grupi ynë. Shoqëruesit nxitoheshin të na futnin nëpër makina e të na largonin sa më parë për të mos na dhënë mundësi të takoheshim me nxënësit. Orvatja qe e kotë. Takimi, përçafimet, puthjet, lotët e nxehtë, duartrokitjet e brohoritjet dhe, më në fund, dhurimi i portretit të Skënderbeut bënë që të jetonim një çast jashtëzakonisht mallëngjyes. Mësuesit e rinj na tregonin se në Pejë kurrë nuk është parë një entuziazëm i tillë. Në raste të tjera nxënësit duartrokisnin shumë ftohtë dhe vetëm me detyrim dhe nxitje.

Një pritje kaq e nxehtë iu bë grupit tonë në Gjakovë, që njihet në gjithë Kosovën për traditat patriotike e revolucionare dhe që shpesh e thërrisin "Tirana e vogël" ose "Gjakova e kuqe". Në këtë qytet vizituam shkollën e lartë pedagogjike 2-vjeçare. Studentët ishin grumbulluar në oborr, gjatë shkallëve dhe në korridoret e shkollës na pritën me përçafime dhe të puthura. S'kishim as dy minuta që kishim hyrë në drejtori, kur u hap dera me forcë dhe dëgjuam britmat: "Në sallë, në sallë!". Drejtuesit qenë të detyruar të plotësonin dëshirën e studentëve. Atyre u foli disa fjalë Aleks Buda, i cili u ndërpre vazhdimisht nga duartrokitje e brohoritje të zjarra. Filluan të thërrisnin "Skënderbeu, Skënderbeu" dhe midis kësaj dëgjohej qartë "Enver Hoxha!". Neve nuk na besohej, por vetë studentët na thanë kur po dilnim: "E dëgjuat kur thërrisnim "Enver Hoxha"?"

Pas kësaj vizite na larguan menjëherë nga Gjakova për në Prizren. U la pa u dhënë koncerti që kishte përgatitur posaçërisht për ne ansambli diletant i Gjakovës "Hajdar Dushi". Në Prizren vizitat u bënë vetëm të nesërmen. Kishin

marrë masa të forta që të mos përsëritej ajo që ndodhi në Pejë e në Gjakovë. E megjithatë në shkollën e Lartë Pedagogjike të Prizrenit delegacionit tonë iu bë prapë një pritje entuziaste, ndonëse numri i studentëve ishte më i pakët se gjetkë.

Nga bisedat me të rinjtë mësuam se organizata e rinisë atje nuk luan asnjë rol, se të rinjtë shqiptarë po gjejnë si formë më të përshtatshme të organizimit dhe të veprimtarisë së tyre krijimin e shoqatave kulturore artistike.

Në këto shoqata bëjnë pjesë kryesisht të rinj dhe zhvillojnë një veprimtari të dendur kulturore artistike. Shoqëri të tilla janë krijuar në shumë qytete të Kosovës, në Dibër dhe në Beograd nga studentët që studiojnë atje.

Shfaqjet që japin ansamblet amatore të krijuara nga këto shoqata shndërrohen në manifestime patriotike dhe të shfaqjes së dashurisë ndaj PPSH, RPSH.

Në programet e këtyre ansambleve përfshihen edhe këngë të tilla si për Llesh Palin, Bajram Currin, Oso Kukën etj., të cilat shpesh ngrenë peshë sallat e shfaqjeve. Zakonisht publiku kur kërkon përsëritjen e këngës thërret “edhe, edhe”, e cila shndërrohet në sallë në “Enver, Enver”.

Ne vumë re se të rinjtë janë të informuar mjaft mirë për çka ndodh në Shqipëri dhe si zhvillohet vendi ynë. Shumë të rinj na thoshin se nuk dëgjonin asnjë radio tjetër përveç Tiranës dhe se mësonin shumë prej saj. Ata na janë lutur që radio Tirana të japë muzikë të kërkuar edhe sipas kërkesave të tyre, gjithashtu që ne të ndërtojmë sa më shpejt stacionin e televizionit afër kufirit për të pasur mundësi të njihen më mirë me vendin tonë.

Të rinjtë dhe shumë njerëz të tjerë që takuam janë shumë entuziastë për të gjitha masat për revolucionarizimin e jetës në vendin tonë që ka marrë Partia. Ata përmendin sidomos vendimin për zhdukjen e diferencave të mëdha midis rrogave etj. Vendimi për elektrifikimin e gjithë fshatrave të RPSH deri më 8 nëntor 1971 i kishte mahnitur. Mjaft vetë nuk mund të konceptonin se si ne pedagogë të universitetit punonim bashkë me studentët në aksionet e rinisë. Habiteshim se si te ne kryenin punë fizike në prodhim gjithë arsimtarët e nëpunësit deri në moshën 55 vjeç pavarësisht nga posti që ata zinin. Lufta kundër mbeturinave borgjeze, zakoneve prapanike e mbeturinave fetare gjente një aprovim jo vetëm në masën e rinisë por edhe në ata pak fshatarë që patëm rastin të takojmë. Të rinjtë na thoshin: “Ju lumtë!”, njëkohësisht shprehnin zemërimin që në krahinën e tyre kishte shumë shkolla fetare dhe me shumë nxënës nëpër mejtepe e medrese se sa studentë në shkollat e larta. Ata revolttoheshin për përkrahjen që tregonte shteti ndaj institucioneve obskurantiste.

Shkurte Pal Vatën e quanin edhe heroinën e popullit kosovar. Ka të rinj që kanë shkruar vjersha për të. Një vjershë për Shkurten e kemi sjellë me vete. Na dhuruan lule për t'i venë në varrin e Shkurtes. Një vazo me lule na e dhanë për ta vënë në varrin e Qerime Galicës [Shotës].

Të rinjtë tregoheshin të gëzuar për punën e madhe që bënte rinia jonë nëpër aksionet e saj. Të shumtë ishin që shprehnin gatishmërinë të vinin në aksionet tona të rinisë. Ne i thoshim që të merrnin iniciativa e aksione për të ndihmuar fshatin, për të zhdukur analfabetizmin, për të përhapur arsimin e për të luftuar zakonet prapanike, si hakmarrjen që ka marrë përpjesëtime të mëdha. Kishin marrë të tilla iniciativa por nuk përkraheshin dhe aprovoheshin nga lart. Tashti së fundi studentët e shkollës së lartë pedagogjike të Gjakovës morën iniciativën që të falnin një muaj bursë dhe të punonin një muaj për meremetimin dhe zgjerimin e shkollave të fshatit dhe për të ndihmuar në përgjithësi për ngritjen dhe zhvillimin kulturor të tij.

Rinia dhe shumë njerëz të tjerë që takuam digjeshin nga malli për atdhe. Serbët i urrenin dhe i konsideronin pushtues, po ashtu i urrenin bashkëpunëtorët e tyre. Atdhedashurinë e tyre e shprehnin me mënyra të ndryshme. Shumë vajza mbanin fund të zi e bluza të kuqe, ose triko me ngjyra kuq e zi. Djemtë mbani kravatë, këmisha e triko kuq e zi. Mjaft vetë kishin nëpër blloqet e tyre të shënimeve fotografinë e shokut Enver. Këndonin këngë shqiptare në mënyrë demonstrative. Këngëve të vjetra e patriotike shqiptare u futnin fjalët, “Enver”, “Kosovë” etj. Në vend të “Moj e mjera Shqipëri”, thoshin: “Moj e mjera Kosovë”. Vetëkuptohet përse shfaqej një dëshirë aq e zjarrtë për të pasur një shenjzë të Skënderbeut me flamurin kuq e zi.

Ne pamë me sytë tanë se si gjatë shëtitjeve në mbrëmje në rrugën kryesore të Prishtinës në një rën anë shëtisnin shqiptarët dhe në anën tjetër serbët. Vajzat mbajnë korrespondencë midis tyre me emrin “shqipet e lira”.

Në bisedat e tyre të rinjtë na shfaqnin një shqetësim, që e përsërisnin shpesh “Jemi të çarmatosur, thoshin. Armët na i kanë marrë. Serbët po armatosen. Nëpër pika të caktuara grumbullojnë armë duke i bartur nëpër arkivole. Ne kemi vetëm ndonjë revole që e kanë blerë në Itali njerëzit tanë që kanë shkuar atje si turistë. A mund të shpresojmë në ndihmën e tuaj me armë?”.

Takime të vërteta me punëtorë dhe me fshatarë nuk patëm. Nuk na krijuan mundësi për takime të tilla. Në dy fabrikat që vizituam, ku kishte dhe një numër punëtorësh [burra dhe gra] shqiptarë, njerëzit ishin mbërthyer pas makinës dhe nuk mund të largoheshin. Na përshëndesnin vetëm me kokë dhe me buzëqeshje. Rroga e punëtorëve në këto dy fabrika [tekstili e konfeksionesh] shkon nga 30000 dinarë të vjetër në 60 000. Një rrogë e tillë konsiderohej fare e pamjaftueshme në krahasim me personelin inxhinjero-teknik dhe drejtuesit e ndërmarrjeve [shumica serbë] që merrnin nga 150 000 deri 500 000 dinarë të vjetër, madje në shumë raste edhe më tepër.

Gjendja e fshatit shqiptar është e rëndë, por sidomos në Maqedoni. Një grusht fshatarësh të pasur shtojnë vazhdimisht tokën dhe pasurinë tjetër të tyre. Ata shfrytëzojnë punën me mëditje. Kanë mundësi të blejnë edhe traktorë. Por ne traktorë në fushë nuk pamë. Masa e fshatarëve e punon tokën me kuaj. Numri i fshatarëve shqiptarë të varfër është shumë i madh, sidomos në zonat

malore dhe pothuaj në gjithë Maqedoninë. Një pjesë e tokave më të mira [në Rrafshin e Dukagjinit e në Kosovë] janë pronë e sipërmarrjeve kapitaliste [shoqërore]. Fshatarët rëndohen me tatime dhe detyrime të larta. Morëm vesh se prodhimi bujqësor në Kosovë është më i vogël se përpara 1941.

Por në përgjithësi fshatarësia e ndjen veten të shtypur rëndë në pikëpamje kombëtare. Prej shumë kilometrash larg kishin ardhur fshatarë në Prishtinë për të na takuar ne e për të na shprehur dëshirat e tyre. Një grup fshatarësh shkoi në Kuvendin e Krahinës të Fadil Hoxha për t'i lejuar të merrnin pjesë në simpozium. Ndër fshatra ishte përhapur fjala se “ka ardhur një delegacion nga Shqipëria në Kosovë për të biseduar çështjen e bashkimit me Shqipërinë”. Ne takuam disa fshatarë nga Suhareka në korridoret e ndërtesës së simpoziumit. Kur i pyetëm: “Si e çoni, si e keni bereqetin, a ka rënë shi?”, një plak u përgjigj: “Kurrë mos raftë shi! Nuk duem shi, duem liri, duem flamurin tonë, duem bashkim!”. Fjalët e tij u përcollën me duartrokitje të zjarra nga grumbulli i të rinjve që na rrethonte. Ne pamë se si derdhnin lotë mallëngjimi fshatarët kosovarë në një takim të rastit e të shkurtër që patëm me ta gjatë rrugës në fshatin Novoselë të Pejës. Nuk çmалleshin dot duke na parë, pa qenë në gjendje ta shprehnin me fjalë atë që ndjenin, por vetëm me lot të zjarrtë.

Shoqet tona bënë takime me një numër të mirë grash. Shumica ishin arsimtare. Numri i grave në simpozium ishte i kufizuar. Veç dy shoqeve tona, mbajtën kumtesa vetëm dy gra të vendit dhe vetëm njëra me kombësi shqiptare. Edhe kjo nuk punonte në Kosovë, por në Institutin e Lëvizjes Punëtore në Beograd. Në institucionet shkencore që vizituam nuk kishte fare gra. Gratë që takuam digjeshin edhe ato nga ndjenjat kombëtare. Arsimtaret bënë çmos për t'u futur fëmijëve shqiptarë këtë ndjenjë. Ne pamë se si fëmijë të vegjël të shollave dhe të moshës parashkollore e quanin veten “stërnipër të Skënderbeut”. Ishte bërë zakon që në familjet e intelektualëve dhe të qytetit në përgjithësi fëmijëve t'u vinin vetëm emra shqip dhe jo myslimanë. Kishte edhe emër “atdhe”. Shumë vajza quheshin “Shqipe”.

Gratë arsimtare vuanin shpirtërisht për gjendjen e mjeruar të fëmijëve shqiptarë. Këtë e tregon më së miri një letër [të cilën e bashkëngjitem] që një arsimtare shqiptare nga Maqedonia ia lëshoi në xhep Aleks Budës.

Gratë kosovare ishin entuziaste për luftën që bëhet në vendin tonë për çlirimin e plotë të gruas dhe për gjithë lehtësirat që i janë krijuar gruas në RPSH për arsim e kulturë, për të marrë pjesë në jetën politike e shoqërore dhe në prodhim.

Takim me njerëz të letërsisë dhe artit dhe çështja e botimeve

Në takimin që pati më 15 maj grupi ynë me njerëzit më të njohur të letërsisë dhe artit në Prishtinë, Hasan Mekuli, kryetar i shoqatës e të tjerë, shprehën “dëshpërimin” që nuk botohen veprat e tyre në RP të Shqipërisë, duke

e quajtur këtë një “inJORIM të plotë” të krijimtarisë letrare artistike shqiptare në Kosovë, e cila është “pjesë e pandarë e krijimtarisë letrare e artistike në shtetin amë”. Ata kërkuan që veprat të cilat konsiderohen si më të mirat të shkrimtarëve, piktorëve, skulptorëve etj. të Kosovës të botohen në RPSH e njëkohësisht të kritikohen anët e dobëta të tyre. Kjo, sipas tyre, do të ishte një inkurajim dhe një ndihmë konkrete për letrarët e artistët kosovarë. Gjithashtu u kërkuan që të bëhen vizita reciproke të letrarëve e artistëve në Kosovë e në RPSH, të dërgohen reciprokisht ansamble e grupe folklorike e artistike këngësh e vallesh etj.

Biseda për këtë çështje vazhdoi tri orë. Ne përfituam nga rasti tua bënim të njohur mirë qëndrimin tonë lidhur me veprimtarinë letrare artistike që zhvillohet në Kosovë. Vumë në dukje se në krijimtarinë letrare e artistike të shqiptarëve në Kosovë e në krahina të tjera të Jugosllavisë ne shohim dy anë: Një anë pozitive që ne e mbështesim dhe e përgëzojmë. Kjo është përpjekja që bëhet për të pastruar gjuhën shqipe nga barbarizmat serbe e turke, për ta përhapur arsimin në gjuhën shqipe, për të ruajtur të gjitha traditat patriotike të shqiptarëve. Ana tjetër, negative, është dobësia e përmbajtjes ideologjike e kësaj krijimtarië, e cila është në kundërshtim me ideologjinë që përshkon krijimtarinë letrare e artistike në RPSH, në kundërshtim me qëllimin dhe detyrat e ndërtimit të socializmit e të komunizmit në Shqipëri. Për këtë arsye kjo krijimtari nuk mund të botohet në vendin tonë. Ne vemi faktorin ideologjik në plan të parë dhe e shohim atë si një faktor që zgjidh jo vetëm problemet e ndërtimit të socializmit por edhe problemin kombëtar. Ne nuk e pushojmë luftën ideologjike sepse e quajmë këtë si një çështje vendimtare. Edhe në RPSH po të shkruhen vepra të dobëta nga ana ideologjike nuk botohen. Të tilla vepra përbuzen dhe flaken poshtë nga masat.

Veç kësaj ne vumë në dukje se në krijimtarinë letrare e artistike në Kosovë gjen shpesh të atilla vepra që është turp t’i konsiderosh një “krijimtari” dhe aq më tepër një “krijimtari shqiptarë”. Këto vepra e bastardojnë kulturën shqiptare. Kritikam rëndë me këtë rast një ekspozitë me piktura e skulptura ultra abstraksioniste që ishte vendosur në fuajenë e teatrit të Prishtinës.

Nuk mohuam se ka edhe ndonjë vepër të mirë që mund të botohej në Shqipëri, por botimi do t’i sillte telashe autorit nga autoritetet jugosllave.

Përsa i përket kritikës që kërkohej t’u bëhej veprave letrare dhe artistike të shqiptarëve në Jugosllavi edhe në pikëpamjen ideologjike, e shpjeguam që kjo nuk do të ishte aspak dobipurëse, sepse kjo do t’u përmbushte qejfin vetëm armiqve të shqiptarëve. Ne e bëjmë luftën në lëmin ideologjik e politik në shkallë Jugosllavie dhe ndërkombëtare dhe nuk mund ta drejtojmë tehun kundër shqiptarëve në Jugosllavi.

Nga të shkelurat e këmbëve, nga të luajturit e syrit e të kokës dukej se një shumicë i aprovonin tezat tona. Këtë na e thanë në takime individuale edhe disa nga ata që ishin të pranishëm. Efekti u duk edhe në vizitën që bëmë të nesërmen

në entin e botimeve. Kur hymë në zyrën e drejtorit, Ramiz Kelmendit, dikush bëri vërejtje me shaka se drejtori e kishte hequr nga muri tablonë [pikturën] abstraksioniste që e mbante prej kohësh në zyrë. Drejtori e pohoi këtë gjë aty për aty dhe tha se nuk kishte për të varur më vepra të tilla në zyrën e vet.

Në vizitat që bëme në dy entet e botimeve dhe të teksteve shkollore na vunë në dijeni për botimet që kishin bërë në gjuhën shqipe të veprave të shkrimtarëve shqiptarë [të vjetër dhe të rinj, të RPSH dhe të Kosovës] e të shkrimtarëve të huaj. Kishin mbaruar botimin e veprave të plota të Sterjo Spases në 8 vëllime dhe po përgatisnin botimin e veprave të Fan Nolit e të Shekspirin. Kishin botuar një numër veprash të veçanta, si “Historia e Skënderbeut” e Fan Nolit, “Hasta la vista” e Petro Markos, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe “Dasma” e Ismail Kadaresë etj. Vëllimi i Historisë së Shqipërisë është në botim e sipër.

Drejtimesit e enteve botuese kërkuan që të firmoset sa më parë kontraktot për dërgimin e letërsisë shqipe nga RPSH, duke dërguar përfaqësuesit tanë në Prishtinë ose duke dërguar ata përfaqësuesit e tyre në Tiranë. Kërkonin që librat të dërgoheshin me një tirazh më të madh. Donin të kishin që më parë listat e librave që ka në plan të botojë Shtëpia botuese “Naim Frashëri” dhe Universiteti Shtetëror i Tiranës për të përcaktuar çfarë libri të porositnin dhe në ç’ tirazh. Po të kishte mundësi, thoshin, të botohen posaçërisht për Kosovën libra të botuara më parë dhe që tani nuk gjenden në shitje. Kërkonin gjithashtu të dërgohen në një tirazh më të madh pllaka gramafoni me këngë shqiptare. Për këtë kishin në dispozicion një fond të posaçëm, 100 000 dollarë për libra dhe 50000 për pllaka.

Libri shqip, si ai që botohej në vend ashtu dhe ai që dërgohej nga RPSH, thithej menjëherë.

Duhet vënë në dukje që shtypja e librave në Prishtinë ishte e një cilësie të mirë, kurse shtypja e librave tona ishte e një cilësie mjaft të ulët.

Kërkesa për letërsi shqipe që botohet në RPSH dhe për pllaka gramafoni ishte shumë më e madhe ndër masat e rinisë. Autoritetet e vendit kishin përhapur fjalë gjoja sikur ato kishin bërë të gjitha përçapjet por kishte pengesa nga autoritetet e RPSH që nuk tregoheshin të gatshëm për të dërguar libra e pllaka gramafoni në Kosovë. Ne i shpjegonim kujtdo që e ngrinte këtë çështje se qeveria e RPSH dhe institucionet botuese shqiptare ishin të gatshëm për të dërguar në Kosovë çdo lloj letërsie që botohet në vendin tonë, me një tirazh sa më të madh dhe duke lënë mënjanë anën komerciale.

Ne pamë përpjekjet për të mbajtur gjallë këngët e vallet popullore, për të zhvilluar folklorin. Këto përpjekje bëhen kryesisht nga rinia e shkollave, nga intelektualë e njerëz të tjerë me ndjenja të zjarrta patriotike. Veprimtaria në këtë drejtim zhvillohet mbi baza diletante. Kurse politika zyrtare në lëmin e kulturës e të artit synonte përhapjen e rrymave të modernizmit, të kulturës borgjeze. Këtë e vumë re në dy dramat që pamë në teatrin e Prishtinës; në

ekspozitën e pikturës; në pikturat dhe skulpturat abstraksioniste në të gjitha anët; në veshjen e njerëzve nëpër qytet.

Ne pamë edhe një koncert të ansamblit profesionist folkloristik me emrin “Shota” në Prishtinë. Ai ekzekutoi këngë e valle popullore shqiptare, serbe e turke. Por këngët e vallet popullore shqiptare kishin vetëm emrin “shqiptare”, sepse në të vërtetë ishin një përzierje e folklorit shqiptar, serb e turk. Rinia në përgjithësi nuk kishte asnjë simpati për “Shotën”. Gjithë drejtuesit ishin serbë dhe me ndonjë përjashtim, të gjithë këngëtarët e valltarët ishin serbë.

Ishin të shumtë ata, nga njerëzit që takuam, që kërkonin me këmbëngulje të dërgohen ansamble nga RPSH për turne në Kosovë.

Në Prishtinë vizituam edhe muzeun e qytetit, i cili kishte një pavijon arkeologjik, një pavijon etnografik, një pavijon të arteve figurative mesjetare dhe një pavijon të luftës nacional-çlirimtare. I gjithë muzeu ishte ndërtuar në atë mënyrë që të vërtetonte kryesisht se Kosova ka qenë prej kohësh sllave. Historia dhe kultura e shqiptarëve sa mezi binte në sy. Dhe ajo pak paraqitej e shtrembëruar. Edhe në pavijonin e luftës nacional-çlirimtare paraqitej çështja sikur vetëm elementi serb në Kosovë kishte luftuar. Asgjë nuk tregojë nga veprimtaria e PKSH në Kosovë, asgjë nuk tregojë nga lufta e brigadave III dhe V të UNÇSH për çlirimin e Kosovës. Veç kësaj, me qëllim të caktuar ishin ekspozuar një letër e shokut Mehmet Shehu dërguar Dushan Mugoshës dhe një letër e shokut Enver dërguar Titos, për të treguar se ne gjithçka ia detyronim PKJugosllave dhe Titos. Drejtori dhe personeli i muzeut ishin serbë.

Kosovarët shqiptarë që na shoqëronin gjatë vizitës mbetën të turpëruar nga vërejtjet tona për muzeun dhe nuk dinin ç’përgjigje të jepnin.

Konstatime të tjera

I. - Përveç lëshimeve që autoritetet jugosllave detyrohen të bëjnë në fushën e arsimit për shqiptarët, që tani duket hapur se ka marrë një hov, nën presionin e masave popullore ata janë të detyruar të bëjnë lëshime edhe në fushën politike. Këto lëshime kanë për qëllim të ulin e të zbutin revoltën e shqiptarëve dhe njëkohësisht t’i mashtrojnë ata duke u munduar të kritikojnë mendimin se në kuadrin e Jugosllavisë kombësitë e ndryshme mund të sigurojnë të gjitha të drejtat e të jenë plotësisht të barabarta.

Në projekt/Kushtetutën janë parashikuar të tilla masa:

1. Të përforcohet autonomia e Krahinës, e cila për çështje themelore të ketë lidhje drejtpërdrejt me Federatën, duke pasur një përfaqësi të vetën aty. Sipas bisedave me anëtarë të Komisionit për ndryshimin e Kushtetutës [Syrja Pupovci, Mark Krasniqi etj.], kjo “i jep autonomi shumë të madhe krahinës dhe e bën të mos ketë shumë ndryshim me republikën”. Gjithashtu ata thanë se ekzistonte mundësia të kërkohej republika por kjo nuk ishte e përshtatshme për

këtë kohë. Fadil Hoxha paska deklaruar se “Po të dojë populli, Kosova mund të shpallet republikë, por kjo do t’i kundërvihej Republikës së Shqipërisë, meqë do të ekzistonin dy republika shqiptare”.

2. Si shenjë e përforcimit të autonomisë së Krahinës, flamuri shqiptar të shpallet si flamuri zyrtar i Krahinës, ose të paktën të jetë i lirë cilido të mbajë flamurin e Shqipërisë, ndërsa 28 nëntori festë zyrtare.

3. Krahina të mos quhet më “Krahina autonome e Kosovës dhe e Metohisë”, por vetëm e “Kosovës”.

4. Gjuhët zyrtare të jenë dy: serbishtja dhe shqipja, ndërsa çdo nëpunës duhet t’i dijë të dyja për t’u futur në punë.

5. Gjuha shqipe të jetë e detyrueshme në shkollat serbe, ashtu siç është e detyrueshme serbishtja në shkollat shqipe.

6. Kuvendi i Krahinës të ketë të drejtë të nxjerrë e të aprovojë për vetë Krahinën etj.

Këto ndryshime do të shqyrtohen në mbledhjen e Skupshtinës në Beograd se më 26 se më 29 maj të këtij viti.

Udhëheqësit e Krahinës po përpiqen t’i shfrytëzojnë këto ndryshime për të fituar kapital për ta shtuar ndikimin e tyre. Me këtë rast duhet të vemi në dukje se midis udhëheqjes së Krahinës nuk ka unitet, se njerëzit me të cilët kemi biseduar janë shprehur mirë për disa e keq për të tjerë. Ndër këta njerëz gjejmë edhe miq e dashamirës tanë. Sipas bisedave me ta, sot në Kosovë udhëheqësit i ndajnë në dy grupe. Në të parin fusin Fadil hoxhën, Ymer Pulën, Ramadan Vranić-in [kryetar i Gjykatës së Krahinës dhe kryetar i Komisionit për të ndjekur e shqyrtuar veprimtarinë e UDB], Iliaz Kurteshin, Kolë Shirokën etj. Disa kanë folë edhe për Mehmet Shoshin, Alush Gashin e Cican, zëvendësen serbe të Fadilit. Këtë grup na e kanë paraqitur “si pozitiv”, që mbron të drejtat e shqiptarëve dhe lufton për to, sidomos Fadil hoxha, i cili gëzon edhe simpati. Për të janë thurur tregime se “Ranković disa herë ka dashur ta zhdukë” etj. Grupi i dytë përbëhet nga Veli Deva, Xhavit Nimani, Bllazho [kryetar i Komitetit Ekzekutiv të LK për Krahinën], Ali Shukriu, Xhevdet Hamza etj. Këtë e kanë paraqitur si grup njerëzish të këqij, të cilët nuk gëzojnë simpati në popull. [Veli Devën në popull e thërrasin me emrin serb “Velo” nga Velimir]. Jo për të mirë përmenden Ismet Shaqiri, Mehmet Hoxha.

Ndërsa grupi i parë është për një autonomi më të madhe dhe për përmirësimin e kushteve të shqiptarëve, i dyti është më konservator, i lidhur me rrymën serbe të Beogradit. Nuk mund të themi asgjë nëse të parët mendojnë të shkojnë më tej nga ndryshimet e përmendura më sipër, ose se duke shfrytëzuar gjendjen mundohen të kalojnë kufirin që lejojnë titistët.

Por ndërsa janë përhapur mjaft iluzione lidhur me këtë politikë “liberalizmi” që po bëhet në Kosovë, në shtresat e gjera të popullit, sidomos të rinisë, po forcohet gjithnjë e më shumë ideja se të drejtat e vërteta do t’i fitojë vetë populli i Kosovës, ai nuk duhet t’i zërë besë udhëheqjes jugosllave, ose

edhe udhëheqjes në Kosovë. Vetë djali i Fadil Hoxhës, i cili ishte kundër të atit [shumica e bijve dhe bijave të udhëheqësve në Kosovë janë kundër etërve të tyre] na deklaroi se flamurin dhe të drejtat e tjera kombëtare s'ka forcë t'ia ndalojë popullit të Kosovës. Ai dhe të tjerë na thanë se ato ditë të vizitës sonë në Kosovë nga rinia u përhap parulla "Liria nuk fitohet me kushtetutë", duke marrë spunto [nxitje] nga teza që u ngrit në njërin nga kumtesat tona se "Shqiptarëve u ka mësuar historia që lirinë të mos ta lypin pora ta fitojnë me luftë, me gjak e sakrificë, se liria dhe pavarësia nuk arrihen me pazarllëqe me sunduesit".

Shumica dërmuese e shqiptarëve të Krahinës, me gjithë ndryshimet shoqërore të tyre, janë për të shkuar më tej, janë për bashkimin me atdheun. Por ndryshimet shoqërore midis shqiptarëve të Kosovës, lenë gjurmë se si do të realizohet ëndrra e tyre shekullore. Prandaj midis tyre gjejmë elementë të moderuar, njerëz të kompromisit, hilesë në politikë i japin rëndësi vendimtare. Gjejmë edhe elementë radikalë, të vendosur, që edhe me armë të realizohet çlirimi kombëtar.

Elementët e parë i gjejmë në radhët e inteligjencës. Inteligjenca kosovare e cila në përgjithësi është e borgjezuar, nuk është homogjene. Ka tipa të tillë që nuk preokupohen fare për fatet e popullit të vet. Synimi dhe ideali i tyre është që të fitojnë sa më tepër, të jetojnë sa më mirë e rehat e, rrjedhimisht nuk dëshirojnë t'u prishet ky rehatllëk. Por duhet shtuar se këta janë të pakët.

Shumica e inteligjencës kosovare, ndonëse borgjeze, është patriote. Kjo e ndjen veten shqiptare dhe e do atdheun. Por ajo nuk është e qartë politikisht dhe ideologjikisht në të gjitha drejtimet. Kjo edhe përcakton luhatjet, ngurrimet e saj. Si fushë të vet të veprimit, ajo konsideron kryesisht arsimin, gjuhën, historinë, letërsinë dhe artin.

Një rrymë intelektualësh, më tepër këta nacionalistë të brezit të vjetër e mesatar, mendojnë se RPSH duhet të ngrëjë çështjen e Kosovës në OKB, pavarësisht se ajo do ta hedhë poshtë kërkesën e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë! Në emër të kësaj rryme këtë kërkesë na e paraqiti mjeku okulist Xheladin Deda, i cili deri më 1943 ka punuar në Tiranë.

Ndër radhët e intelektualëve ka edhe një pjesë të vogël në numër, por revolucionarë, e cila e urren titizmin edhe nga pozitrat kombëtare edhe nga pozitrat ideologjike.

Titistët po përpiqen të degjenerojnë inteligjencën shqiptare me çdo mjet.

Po ta përmbledhim shkurtimisht gjendjen në Kosovë mund të themi: Kosova është një kazan që zien, një vullkan, siç e përcaktoi një historian gjerman, që mori pjesë në simpozium, që mund të shpërthejë nga dita në ditë.

II. – Simpoziumi kushtuar Skënderbeut dhe ndezja në përgjithësi e atmosferës patriotike që shkaktoi vizita e grupit tonë në Kosovë e alarmoi reaksionin serb, i cili reagoi në mënyra të ndryshme.

Nxënës dhe studentë serbë bënë manifestime në rrugë kundër simpoziumit. Në mure u shkruan parulla si “Kosova është serbe [Kosovo je serbsko], “Shqiptarët në Shqipëri” [Shiptari u Albaniju], “poshtë Enver Hoxha”, “Serbë bashkohuni” etj. Letra të shumta kërcënuese iu dërguan fotografit, që sipas kërkesave të panumërta riprodhonte e shiste fotografi nga simpoziumi. Në letrat ishin vizatuar thika me gjak që preknin zemrën e fotografit. Tek zëvendësja e Fadil Hoxhës shkoi një grup përfaqësuesish i serbëve për të protestuar kundër simpoziumit, i cili gjoja kishte si synim kryesor shkëputjen e Kosovës nga Serbia.

Ne mësuam atje se reaksioni serb është në aktivitet të madh. Shovinizmin serb e tremb shumë gjallërimi i ndjenjave dhe veprimtarisë me ngjyrë kombëtare në Kosovë. Në shumë komuna e në sipërmarrje kryhen sabotime nga serbët dhe për këtë akuzohen shqiptarët. Këto shërbejnë si shkas për t’i pushuar ata nga puna. Në Preshevë me këtë qëllim serbët dogjën ndërtesën e komunës. Në Mitrovicë, kishin kurdisur një incident artificial, duke e akuzuar drejtorin e gjimnazit, një shqiptar patriot, për përdhunim të nxëneseve dhe duke e çuar për këtë “faj” në gjyq. Qëllimi ishte për të zëvendësuar drejtorin shqiptar me një serb etj. Reaksioni serb në Kosovë po armatohet “ilegalisht”. Veç asaj, në Kosovë ne vumë re se ka një numër të madh trupash të armatosur jugosllavë.

III. - Fadil Hoxha dhe grupi i tij që përpiqet të marrë në dorë flamurin e të drejtave kombëtare të shqiptarëve, nga sa mësuam, ka ngritur zërin kundër trajtimit që u bëhen shqiptarëve në Maqedoni nga grupi i Cervenkovskit.

Në një plenum të KQ të LK të Maqedonisë janë ngritur këto çështje, të cilat grupi i Fadilit i ka kundërshtuar.

1. Në Maqedoni nuk ka pas shtrembërime në marrëdhëniet midis kombësive, shqiptarët kanë qenë të barabartë me maqedonasit.

2. Në Maqedoni nuk ka arsye që njerëzit e aftë për punë të inkuadrohen në punë sipas përpjesëtimit të popullsisë. Në punë do të futet ai që është i aftë. Për të përforcuar këtë tezë merret si shembull Sllovenia, ku ka njerëz më tepër në punë se sa në Serbi. Grupi i Fadilit duke e kundërshtuar këtë, kërkon që në punë të jenë aq shqiptarë sa ç’është përqindja e tyre në Maqedoni.

3. Grupi i Cervenkovskit kritikon tendencën për të vendosur marrëdhënie paralele midis shqiptarëve, meqë e konsiderojnë si ndërhyrje të Kosovës në punët e brendshme të Republikës Maqedone. Grupi i Fadilit është i mendimit se Krahina e Kosovës ka të drejtë të mbrojë interesat e shqiptarëve dhe në të gjitha republikat e Jugosllavisë.

IV. - Gjatë qëndrimit tonë në Shkup, në bisedë me shqiptarë, morëm vesh se qenka arritur një marrëveshje me turqit, që nga Maqedonia gjatë vitit 1969 të

shkojnë në Turqi 180 000 shqiptarë. Kjo, sipas fjalëve të shqiptarëve, do të ishte katastrofë, për arsye se popullsia shqiptare do të përgjysmohej.

V. - Përsa i përket gjyqit të fundit të Manastirit kundra disa nënshtetasve jugosllavë me kombësi shqiptare, gjithkund ai cilësohej si një gjyq provokues, i kurdisur me qëllim të caktuar. Këtë mendim na thanë sikur e kishte dhe grupi i Fadil Hoxhës.

VI. - Në Kosovë vazhdojnë të mbajnë nëpër burgje mjaft njerëz. Për çështje politike nuk ka të burgosur serbë e malazezë në Kosovë. Po bëhen disa përpjekje mashtruese për të liruar të burgosurit politikë shqiptarë, kuptohet pjesërisht.

Duke i hedhur fajin Ranković-it për padrejtësitë e bëra në të kaluarën, propaganda zyrtare përhap mjaft iluzione në lidhje me “kthesën” që është bërë e do të thellohet më tej në Kosovë. Ajo përpiqet ta paraqesë këtë si një çlirim të dytë. Nga masat e popullit u kërkua që të merren masa të rrepta kundër atyre që kishin bërë krime. Në Kosovë u krijua një Komision Special për të hetuar shkeljet e ligjshmërisë. Komisioni kryesohet nga Vranić [kryetar i Gjykatës së Krahinës]. I vetmi përfundim është se shumë udbashë [ish punonjës të Sigurimit Jugosllav – UDB], pasi kanë siguruar pensionin, janë larguar e jetojnë rehat në Beograd. Ndonjë ndjekje ligjore është zhvilluar, por pa rëndësi, ndërsa në burg, me sa na thanë, nuk është futur asnjë nga funksionarët e UDB-së.

VIII. - Mbi anulimin e gjyqit të Prizrenit të vitit 1956, gjyq që ka pas qenë drejtuar kundër RPSH. Na thanë se ky gjyq ka pasur si pikësynim të eliminonte e të diskreditonte kuadrot shqiptare. Të akuzuarit kryesorë kanë qenë Sadat Dida, ish kryeredaktor i “Rilindjes” dhe Njazi Maloku [të dy anëtarë të PKJ]. Në këtë grup kanë qenë futur edhe disa pjesëtarë të familjes Shehu të Prizrenit, që njiheshin si nacionalistë. Në gjyq e hetuesi, nga torturat, Maloku ka pranuar se ka qenë “agjent i shqiptarëve” dhe se “ka punuar për ta”. Dida ka qëndruar mirë e nuk ka pranuar asgjë. Disa kosovarë na kanë thënë se gjyqi është anuluar e të dënuarit janë liruar, për arsye se kanë qenë të interesuar disa nga udhëheqësit e Krahinës. Këto “interesa” të këtyre udhëheqësve nuk mundëm t’i marrim vesh. Ali Dauti, i cili në atë kohë ka qenë kryetar i pushtetit [Komitetit Ekzekutiv] të Prizrenit dhe i cili, si thotë vetë, ka marrë pjesë në seancën e parë të gjyqit, shtoi se në listë për t’u arrestuar kanë qenë dhe të tjerë. Ai deklaroi edhe “janë bërë përpjekje për t’u marrë të pandehurve deklarata kundër Fadil Hoxhës”. Ali Dautit nuk mundën t’i shkulim ndonjë send tjetër, për arsye se ai si njeri i UDB duhet të dijë edhe shumë hollësi të tjera. Ai tha se gjyqi i

Prizrenit është bërë me dyer të mbyllura dhe për të nuk ka ditur gjë populli. Është marrë vesh në popull vetëm kur është anuluar.

Morëm vesh se për këtë gjyq, gazeta e Zagrebit “Vjesnik” ka përgatitur një artikull të gjatë. Deri më sot botimi i këtij artikulli është penguar nga Beogradi. Drejtori i “Vjesnik”, i cili ka botuar në rregull lajmet mbi simpoziumin e Prishtinës është “i vendosur të botojë artikullin”.

Ndër intelektualët shqiptarë kosovarë kishte mendime se “udhëheqja e Kroacisë duke luftuar me serbët, “mbështet shqiptarët”. Edhe Vladimir Bakarić, që ka si pikësynim të dobësojë pozitat serbe dhe forcimin e pozitave kroate, “i përkrah shqiptarët”. Por ai që qenka në pozita shumë më të shëndosha e më dashamirëse është Bielić, anëtar i Kryesisë së KQ të LK të Kroacisë. “Edhe të sllovenët gjejnë përkrahje shqiptarët”. Madje mjaft kishin mendim se edhe Kardeli “i ndihmon shqiptarët”!

IX. - Me bisedat me të rinjtë, u bëri përshtypje shumë të madhe shkollimi i një numri të mirë kosovarësh në vendin tonë. Ata shprehën dëshirën e zjarrtë që të mësojnë në Tiranë. Mbetën të prekur nga kujdesi që tregohet në vendin tonë për ta dhe u shprehën se edhe ata duhet të mësojnë për të qenë të dobishëm për popull e atdhe. Vetë djali i Fadil Hoxhës, i cili gjatë këtyre katër vjetëve studimi është ende në vitin e dytë të fakultetit juridik tha: “Në Tiranë fakultetin do ta kisha kry për katër vjet, por këtu nuk po mundem”.

Kur pat ardhur në fillim në Shqipëri delegacioni i parë i kosovarëve, në biseda me rektorin e universitetit tonë, pat kërkuar që në Tiranë të vijnë të studiojnë studentë kosovarë. Tani nga kjo kërkesë kanë hequr dorë. Kërkohej që të vinë studentë për dy tre javë ose një muaj për praktikë, por jo për studime. Gjithashtu propozohet që të vijnë njerëz të diplomuar për specializim. Duke marrë parasysh jehonën jashtëzakonisht të madhe që do të gjente në rininë kosovare, mendojmë që Universiteti ynë të shpallte një seri të konsiderueshme bursash për të rinjtë kosovarë. Kjo do të kundërvinte përballë njëra tjetrës rininë me udhëheqjen dhe do të bënte që të shtoheshin kërkesat e saj. Nga ato informata që kemi, ky propozim nuk do të pranohej dhe kjo do t’i hapte më tepër sytë rinisë e popullit për manovrat e udhëheqjes dhe do ta rriste pakënaqësinë ndaj saj.

*Mbi takimin e Bujar Hoxhës me Ilia Vakić-in,
kryetarin e Komitetit Ekzekutiv të Krahinës*

Pasi Bujari nuk pranoi t’i përgjigjej kërkesës së Fadil Hoxhës për një takim, Ilia Vakić gjeti rastin për të biseduar me Bujarin, në emër edhe të Fadil Hoxhës, në pritjen zyrtare që dha Sali Nushi për delegacionet e huaja.

Ilia Vakić shtroi nevojën e bashkëpunimit të ngushtë me ne. Ai shprehu mendimin se Krahina e Kosovës nuk mund të lidhet ekonomikisht ngushtë me

Shqipërinë, aq ngushtë sa që lidhjet ekonomike të përbëjnë një njësi të vetme ekonomike të pjesës [Kosovë] me të tërën [Shqipëri]. “Ne jemi gati, shtoi ai, të bëjmë tregti me ju edhe duke mos pasur leverdi e fitime dhe jemi në gjendje të blejmë shumë mallra. Nuk ka asgjë që të jetë e tillë sa ne të na ndajë. Mosmarrëveshjet që kemi, të ulemi e t’i zgjidhim në tavolinë së bashku”. Pastaj shtoi: “Mos harroni se keni një milion shqiptarë këtej, që kërkojnë të kenë lidhje me ju. E kaluara nuk kthehet më. Ne i njohim gabimet tona në marrëdhëniet me Shqipërinë, por edhe ju keni tuajat”. Me këtë në radhë të parë ai nënkuptonte ndërhyrjen e vitit 1956. Po për këto çështje Fehmi Agani i pat thënë Bujarit në Tiranë, me rastin e vizitës së tyre të parë, se ndërhyrja e vitit 1956 ka qenë gabimi më i madh i Jugosllavisë. Sipas Fehmiut, ky është mendimi zyrtar i jugosllavëve dhe kjo periudhë nuk mund të kthehet më. Ai pat shtuar se për Jugosllavinë është shumë më mirë një Shqipëri e pavarur, si kjo e sotmja”. Ky qëndrim i Jugosllavisë paska filluar pas prishjes së marrëdhënieve tona me BRSS. Po këto gjëra i përsëriti më vonë edhe Syrja Popovci.

Pyetjes së Bujarit “Pse nuk i botoni në shtyp gabimet tuaja, për të dhënë një farë prove se nuk keni ndërmend t’i përsëritni”, Ilija Vakić nuk i dha përgjigje, por shtoi: “Edhe pse jemi kështu, ne kemi interesa të përbashkëta”. Së bashku me Elhami Nimanin, që ndodhej i pranishëm në bisedim, thanë se “Po të sulmohet Shqipëria e para që do të futet në luftë është Jugosllavia”. Ilija tha: “Së paku të përmirësohen marrëdhëniet në rrugë shtetërore. Për bashkëpunim dhe përmirësim marrëdhëniesh me ju është vetë Tito. Në punët tuaja të brendshme nuk ndërhyr më njeri. Kësaj i ka kaluar koha”.

Ilija foli pastaj për vështirësitë që iu dalin atyre për shkak të sulmeve tona. Ai shtoi: “Të gjithë ne, që jemi për afrim e bashkëpunim, vihemi në pozitë shumë të vështirë. Josip Broz Tito është kryetar shteti, prandaj nuk duhet sulmuar me atë mënyrë si bëni ju”. Ai kërkoi pushimin e kritikës ose së paku zbutjen e saj. Këtu i mbajtën iso Elhami Nimanin dhe Ismet Mula, duke thënë se Titon e dashkan popujt e Jugosllavisë dhe se paska autoritet të madh në botë. Po aty Ismet Mula shprehu mendimin së Elhamiu të vijë përfaqësues i Jugosllavisë në Tiranë dhe Elhamiu nuk kundërshtoi.

Grupi i punonjësve shkencorë të Universitetit që vizitoi Kosovën

Aleks Buda
Ndreçi Plasari
Bujar Hoxha
Dhorka Dhamo
Mediha Shuteriqi
Thoma Murzaku.

Tiranë, 25 maj 1968

Burimi: AMPJ, Viti 1968, Dosja 360, fl. 201-231.

